



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 148 – Mars – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë përkujtimit të ngjarjeve të marsit të vitit 1999



Përmbajtja:

Begaj: Kapaciteti i energjisë elektrike, i pamjaftueshëm për nevojat e Malishevës	4
Filloi ndërtimi i shkollës në Astrazup	5
U promovuan veprat historike të dy autorëve kuksian.....	6
KK i Malishevës, miratoi rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale	7
Po shënohet “Epopëja e UÇK-së”	8
Asfaltohet rruga Bubël – Turjakë.....	9
Qendra e Kompetencës, mori emrin e dëshmorit “Kujtim Krasniqi”	10
Malisheva, shënoi Ditën e Mësuesit.....	11
Rritja e nivelit të ujit ka bllokuar dy rrugë	12
Kryetari Begaj uron mësuesit me rastin e 7 Marsit.....	13
Qetësohet situata nga përmbytjet e djeshme në Malishevë.....	13
Nga java e ardhshme fillon fushata e repelimit të kafshëve.....	14
U mbajt aktivitet për nderë të Ditës Ndërkombëtare të Gruas	14
Është bllokuar rruga Mirushë-Gurbardh	15
Bizneset turke të interesuar për bashkëpunim me Malishevën	16
Bie niveli i ujit në lumin Mirusha	17
Melos Ulluri, zgjidhet kryetar i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Malishevë	17
Filloi cikli i parë i repelimit të kafshëve	18
Java e kaluar, është përcjellë me përmbytje por dëmet nuk kanë qenë të mëdha	19
Komiteti për arsim mbajti mbledhjen e tretë të rregullt	20
Begaj: Vizita në Gjermani, e frytshme.....	20
Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e tretë të rregullt.....	21
Komuna po vazhdon me ndërtimin e infrastrukturës shkollore	22
Filloi realizimi i projektit të serrave për 15 bujq malishevas.....	23
ATK rimbyllë dy lokale të lojërave të fatit	23
Kryetari Begaj, priti komandantin e LMT-së në Malishevë	24
Edhe një sukses i nxënësve të Malishevës, në garat e matematikës	25
Kryeministri Mustafa, shikoi nga afër dëmet nga vërshimet e janarit dhe marsit në Malishevë	25



Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e radhës	27
Pas 17 viteve, asnjë i dënuar për vrasjen e 42 shqiptarëve	27



Begaj: Kapaciteti i energjisë elektrike, i pamjaftueshëm për nevojat e Malishevës

Malishevë, 1 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune, Avni Alidemaj, drejtor i sistemit të operimit në KEDS dhe përgjegjësit tjetër të KEDS-it nga distrikti i Gjakovës dhe njësisë së distribuimit në Malishevë, me të cilët ka biseduar për investimet aktuale të KEDS-it, si dhe për investimet e mundshme në rrjetin e energjisë elektrike në Komunën e Malishevës, pasi rrjeti aktual dhe kapaciteti i energjisë, nuk i plotëson

nevojat e Malishevës.

Fillimisht, drejtori Alidemaj, e njoftoi për investimet në Malishevë, siç është investimi i fundit në ndërtimin e një trafo për pompat ujit në Senik, si dhe për angazhimet tjera të KEDS-it. Po ashtu Alidemaj, shprehi mirënjohje për gatishmërinë e komunës, dhe për bashkëpunimin e mirë.

Kryetari Begaj dhe drejtori Alidemaj, biseduan edhe për mundësinë e investimit në rregullimin e rrjetit elektrik në qytetin e Malishevës, përkatësisht në rrugët kryesore, ku planifikohet largimi i shtyllave dhe futja nëntokë e rrjetit elektrik.

Më pas kryetari Begaj, shprehi pakënaqësinë e tij për gjendjen aktuale të furnizimit me energji elektrike në Malishevë. “Kapaciteti i pamjaftueshëm i energjisë elektrike, është pengesë në zhvillimin e Malishevës. Po ashtu në shumë vendbanime, qytetarët detyrohen të përdorin përforcues të rrymës, prandaj kemi nevojë për rritje të kapacitetit dhe rregullimin e rrjetit aktual nëpër fshatra, pasi në shumë fshatra rrjeti është i viteve të ‘60 – ta. Ne si komunë jemi të gatshëm të ndihmojmë në këtë drejtim, por është e padrejtë që të mos investohet në Malishevë”, tha kryetari Begaj, gjatë bisedës me përfaqësuesit e KEDS-it. Më pas kryetari Begaj, i paralajmëroi përfaqësuesit e KEDS, se “jemi të pakënaqur dhe mund të ketë edhe shprehje të pakënaqësisë në forma të ndryshme, pasi kapaciteti i energjisë elektrike, është e pamjaftueshme”.

Kryetari Begaj, ka kërkuar që në Malishevë, të ndërtohet stacioni 110kv, pasi energjia në Malishevë vjen vetëm 35 kv, që është shumë e pamjaftueshme për nevojat e Komunës së Malishevës. Në këtë takim u bë e ditur, se sipas planifikimeve të mëhershme të KEK-ut, në vitin



2010 është dashur të filloj ndërtimi i stacionit 110 kv, por se pse nuk ka filluar kjo dhe si ka ikur ky investim nga Malisheva, nuk ka informacione.

Edhe drejtuesit e KEDS në Malishevë, gjithashtu thanë se Komuna e Malishevës, i përkrahë në aktivitetet e tyre të përditshme, megjithëse qytetarët kanë nevojë për më shumë investime dhe rritje të kapacitetit, pasi kapaciteti aktual është i pamjaftueshëm për nevojat e ekonomive familjare apo bizneseve.

Për këtë çështje, kryetari i Komunës së Malishevës, gjatë muajit të kaluar ka zhvilluar takime me përgjegjësit e KOST-it, ZRRE-së dhe me drejtorin e KEDS-it, ku ka kërkuar përkrahje për ndërtimin e stacionit 110 kv në Komunën e Malishevës, si nevojë emergjente për furnizim stabil me energji elektrike.

Filloi ndërtimi i shkollës në Astrazup

Malishevë, 2 mars

Sot në fshatin Astrazup, ka filluar ndërtimi i objektit të shkollës “Ganimete Tërbeshi”. Në ceremoninë e gurëthemelit, ku mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i uroj nxënësit, mësimsdhënësit dhe banorët e fshatit Astrazup për fillimin e ndërtimit të këtij objekti dhe tha se “një prej prioriteteve të komunës, vazhdon të mbetet arsimit dhe për këtë qëllim, edhe investimet do të vazhdojnë në shkollat e komunës sonë”.



“Ju uroj të gjithëve për fillimin ndërtimit të këtij objekti shkollor, shumë të nevojshëm për fëmijët e fshatit Astrazup. Sot është një ditë gëzimi për të gjithë ne, për ju nxënës, mësimsdhënësit e ju banorë të Astrazupit, pasi e meritoni të keni në objekt të këtillë shkollor, i ndërtuar sipas standardeve”, tha kryetari Begaj në ceremoninë e vënies së gurëthemelit. “Prioriteti ynë është rritja e cilësisë në arsim dhe këtë duhet ta bëjmë përmes investimeve, duke krijuar kushte për rritjen e cilësisë së arsimit, prandaj edhe investimi në objekte shkollore, me standardet e kërkuara, është pjesë e këtij angazhimi dhe investim në të ardhmen tonë”, tha Begaj.



Betonin e parë në gurëthemlen e kësaj shkolle, e vendosën i pari i Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i arsimit në Malishevë, Avdi Morina, u.d. i drejtorit të shkollës Adem Krasniqi dhe drejtori i urbanizimit në Malishevë, Ahmet Morina.

Kjo shkollë, aktualisht ka rreth 450 nxënës, ndërsa ndërtimi i objektit të SHMU “Ganimete Tërbeshi” në Astrazup, financohet nga Komuna e Malishevës, dhe buxhetit komunal i kushton 526 195.74 Euro. Ky objekt do të jetë i ndërtuar sipas standardeve të kërkuara, me një hapësirë prej 2 909 metra katrorë, tri katërshë, me 18 klasa mësimi. Punëkryes janë NNT “Arbëri NS” sh.p.k. dhe NT ”Alfa”.

U promovuan veprat historike të dy autorëve kuksian

Malishevë, 2 mars



Sot në Komunën e Malishevës, janë promovuar tri vepra të dy autorëve shqiptar nga Kukësi, Rexhep Shahu dhe Izet Duraku, vepra të cilat prezantojnë fakte historike për planifikimin e shpërnguljeve të shqiptarëve, shqiptarët në raport me fuqitë e mëdha dhe depërtimin e përgjuesve serb. Në këtë promovim, mori pjesë edhe Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemajl Minxhozi, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj dhe personalitete të shumta publike,

historian e letrarë. Promovimi i këtyre veprave, është organizuar nga shoqata e shkrimtarëve “Tafil Kelmendi” në Malishevë.

Fillimisht në fjalën e tij, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, foli për ngjarjet historike nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar, përfshi edhe shpërnguljet dhe planifikimet serbo-sllave për shfarosjen e shqiptarëve, që edhe këto vepra i dedikohen asaj periudhe dhe atyre ngjarjeve. “Me këtë rast i falënderoj autorët për shkrimin e historisë, në mënyrë që të kujtohet historia jonë”, tha Begaj.

Ndërsa ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemajl Minxhozi, duke folur për autorët, tha se “janë dy figura të nderuara, të letërsisë, artit dhe historisë”. “Unë ju falënderoj për ftesën, por i falënderoj edhe autorët që kanë zgjedhur Malishevën, për promovimin e këtyre veprave, me



rëndësi historike, pasi Malisheva, është një qytet i vogël, me një të kaluar të lavdishme në historinë e popullit shqiptar”.

Më pas, njohës të letërsisë dhe historisë, nga Malisheva, Prizreni, Gjakova e Shqipëria, si Izet Shala, Mehdi Krasniqi, Muharem Kurti, Eqerem Kryeziu dhe të tjerë, folën për rëndësinë historike të këtyre veprave, ku pasqyrohet në mënyrë faktike, e gjithë periudha e tentimit të shpërnguljes së shqiptarëve, si dhe ana artistike dhe letrare, ku i vlerësuan jashtëzakonisht lartë këto botime.

Në këtë ngjarje, janë promovuar librat “Përgjuesi serb i Ismail Qemalit”, “Shqiptarët e fuqitë e mëdha” dhe “Shpërngulja e shqiptarëve” e autorëve Rexhep Shahu dhe Izet Duraku.

KK i Malishevës, miratoi rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale

Malishevë, 4 mars

Kuvendi i Komunës së Malishevës, kryesuar nga kryesuesi Aziz Thaçi, sot ka mbajtur mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2016. Në mbledhjen e sotme ka dhënë betimin anëtarë të ri të KK-së, Faton Krasniqi nga subjekti i IQM-së, cili zëvendëson ish anëtarin e derisotshëm Avdi Morinën. KK i Malishevës, po ashtu ka miratuar edhe rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2016.

Në këtë mbledhje, anëtarët e KK të Malishevës, kanë shqyrtuar dhe miratuar tri kërkesa të kryetarit të Komunës të cilat kanë të bëjnë me ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parashtruara nga kërkesa këto nga Lulzim Kryeziu përfaqësues i AL-Petrol-shp.p.k, kërkesa tjetër të Bahtijar Zogajt nga fshati Turjakë, dhe kërkesa e Alush Krasniqit nga fshati Negrovç, KK- Drenas.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, KK i Malishevës, ka shqyrtuar dhe miratuar edhe raportin e punës së KKS-së, për vitin 2015.

Në këtë mbledhje anëtarët e KK të Malishevës shqyrtuan dhe miratuar edhe tri plane të punës, atë të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Qendrës për Punë Sociale dhe planin e punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2016.



Po shënohet “Epopoja e UÇK-së”

Malishevë, 6 mars



Në kuadër të shënimeve të “Epopesë së UÇK-së”, Kuvendi i Komunës së Malishevës, sot ka mbajtur një seancë solemne, si dhe janë bërë homazhe e nderime te Shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, në Malishevë, pastaj vizita tradicionale në Prekaz, si dhe homazhe te varrezat e dëshmorëve në Kleçkë e Malishevë.

Fillimisht Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur një seancë

solemne, për nder të epopesë së lavdishme të UÇK-së. Në fjalimet e mbajtura nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, z.Aziz Thaçi, u çmua lart lufta e UÇK-së, me në krye Komandantin Legjendar Adem Jashari dhe sakrifica e Familjes Jashari, më 5,6 dhe 7 mars.

“Ne sot e kujtojmë me respekt të thellë heroizmin dhe qëndresën heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari. Të përkujtosh njerëzit e mëdhenj, është borxh, nder dhe respekt, bujari dhe fisnikëri. Duke nderuar dëshmorët e kombit, rrugëtimi ynë drejtë një të ardhme më të mirë ndritur, është i sigurt”, tha mes tjerash në fjalën e tij, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi.

Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, tha se “një sakrificë e tillë, si atë të Familjes Jashari, nuk ka njohur kurrë bota. Adem Jashari dhe Familja Jashari, u sakrifkuan për një qëllim të vetëm, e ai qëllim, ishte liria e vendit. Kjo sakrificë, u bë kushttrim i lirisë, e këtij kushtrimi, ju bashkua i tërë vendi. Thirrjes për luftë, shumë fuqishëm, ju bashkua edhe Malisheva, çdo familje dhe çdo banor, ju bashkua kësaj thirrje. Malisheva dha mijëra ushtarë, të organizuar në dy brigada, dha mbi 70 dëshmorë, qindra ushtarë mbetën invalid, dhjetëra qytetar të Malishevës u zhdukën, e qindra civil u vranë. Kjo ishte lavdia e UÇK-së dhe kjo është ngjarja më heroike dhe më e lavdishme në historinë e popullit shqiptar.

Pas mbledhjes, Kryetari i Komunës z.Ragip Begaj, i shoqëruar edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Enver Hoti dhe nga kabineti i tij, anëtarët e KK të Malishevës, familje të dëshmorëve



dhe qytetar të tjerë, kanë bërë homazhe pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, për vizituar pastaj edhe Prekazin legjendar. Në Prekaz, përveç nderimeve tek varrezat, është vizituar edhe kulla e Jasharajve, ku delegacioni nga Malisheva, është pritur nga kryefamiljari Rifat Jashari. Më pas, janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Kleçkë dhe në Malishevë.

Aktivitetet vazhdojnë në ditën e nesërme.

Asfaltohet rruga Bubël – Turjakë

Malishevë, 7 mars

Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në Komunën e Malishevës, është duke u asfaltuar rruga Bubël - Turjakë, rrugë e cila i lidhë këto dy fshatra mes vete. Asfaltimin e kësaj rruge, e kanë parë nga afër edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit z.Ahmet Morina, të cilët edhe i kanë uruar banorët e dy fshatrave, për rrugën.



“Qëllim i yni kryesor është rritja e mirëqenies së qytetarëve, përmes investimeve konkrete në infrastrukturën e përgjithshme, e në veçanti asaj rrugore. Edhe kjo rrugë është në kuadër të kësaj përpjekje, pasi lidhja mes dy fshatrave ka qenë e nevojshme, si për lëvizje mes dy fshatrave, ashtu edhe për shkurtimin e rrugës, për tu lidhur ne shiritin kryesor të rrugës, e cila lidhet me qendrën komunale”, tha kryetari Begaj, dhe i uroi banorët e këtyre dy fshatrave. Nga ana tjetër banorët, shprehën falënderimin e tyre për këtë mundësi të krijuar nga ana e komunës.

Drejtori i urbanizimit, z.Ahmet Morina, tha se “kjo rrugë është asfaltuar nga buxheti komunal i Malishevës dhe kap një shumë prej 84 862 Euro, kurse gjatësia e rrugës që lidh dy fshatrat është 1170 metra dhe gjerësia pesë metra”.



Qendra e Kompetencës, mori emrin e dëshmorit “Kujtim Krasniqi”

Malishevë, 7 mars



Në kuadër të shënimeve të Epopesë së lavdishme të UÇK-së dhe Ditës së Mësuesit, shkolla e mesme profesionale në Malishevë, u emërtua me emrin e dëshmorit të kombit Kujtim Krasniqi, ndërsa u zbulua edhe busti i dëshmorit, në oborrin e kësaj shkolle profesionale. Zbulimin e bustit, e bënë nëna e dëshmorit, kryetari i NISMA për Kosovën, Fatmir Limaj dhe bashkëluftëtarët e dëshmorit Kujtim

Krasniqi.

Paraprakisht, në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, është mbajtur një akademi, kushtuar dëshmorit të kombit Kujtim Krasniqi, ku u vlerësua lartë jeta dhe vepra e dëshmorit, heroizmi i tij, deri në momentin e rënies në altarin e lirisë, për të mos vdekur kurrë.

“E dashur nënë Salë (nëna e dëshmorit Kujtim Krasniqi), sot është një moment i veçantë për të gjithë. Ajo që sot na bashkon këtu, është krenaria për një djalë, për një bashkëluftëtar dhe një bashkëvendës. Emri i Kujtim Krasniqit, do të jetoj për jetë”, tha në fillim të fjalës së tij, Fatmir Limaj, kryetar i NISMA për Kosovën dhe deputet i Kuvendit të Kosovës. Pastaj, duke folur për Epopenë e UÇK-së, z.Limaj, tha se “askush më shumë se treva e Malishevës, nuk ju ka përgjigjur kushtimit të Adem Jasharit, e ndër ta edhe Kujtim Krasniqi”. “Tempujve të dijes dhe të kulturës, po ju shtohet edhe emri i Kujtimit, sikur që kjo shtëpi e kulturës mban emrin e Tahir Sinanit, gjimnazi që mbanë emrin e Hymdi Berishës, pallati i sporteve që mban emrin e Habib Zogajt, ashtu edhe qendra e kompetencës do të mbaj emrin e Kujtim Krasniqit, e këta emra janë ata që na sollën lirinë”, tha Limaj. Më pasi, dha një mesazh për mësuesit e kësaj vatre shkolle, ku tha se “ky bust, nuk është thjeshtë material, ky emër, nuk është thjeshtë një emër, por ky emër është vet liria që sot gëzojmë”. Fatmir Limaj, përgëzoi komunën, për iniciativën e ndërmarrë dhe emërtimin e Qendrës së Kompetencës, me emrin e dëshmorit Kujtim Krasniqi.



Ndërsa nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, duke folur me këtë rast, tha se “sot në kuadër të shënimit të “Epopesë së UÇK-së” dhe Ditës së Mësuesit, jemi dëshmitar të zbulimit të bustit të dëshmorit Kujtim Krasniqi, i cili sot e tutje i bën nder me emrin tij Qendrës së Kompetencës, dhe ne të gjithë duhet të angazhohemi me kompetencë, ashtu siç ishte i angazhuar me kompetencë edhe dëshmori Kujtim Krasniqi, i cili është emër i madh i luftës së lavdishme të UÇK-së”.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim në Malishevë, z.Avdi Morina, tha se “nga sot, ky pedestal, do të shikoj në drejtime nga e kaluara e lavdishme e luftës çlirimtare dhe nga e ardhmja e ndritshme e shtet ndërtimit, e para themeltar dhe e dyta kurorëzuese”.

Për jetën dhe veprimtarinë e dëshmorit Kujtim Krasniqi, folën edhe bashkëluftëtarët Hafir Kryeziu dhe Refki Mazreku, ndërsa në emër të familjes, ka falënderuar Blerim Krasniqi, vëlla i dëshmorit.

Malisheva, shënoi Ditën e Mësuesit

Malishevë, 7 mars



Sot në Malishevë, organizuar nga Drejtorja për Arsim dhe Edukim, është shënuar 7 Marsi, Dita e Mësuesit, përmes aktivitete të ndryshme, ndërsa aktiviteti kryesor, është mbajtur në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani”, ku edhe janë dhënë mirënjohje për shkollat më të mira dhe arsimtarët më të mirë, në fusha të ndryshme.

Në takim të organizuar nga DKAË, nënkryetari i Komunës së Malishevës,

Raxhep Mazreku, fillimisht i ka falënderuar të gjithë veteranët e arsimit, për kontributin e tyre në shkollat e Komunës së Malishevës, për dekada të tëra. “Ne si komunë, i çojmë dhe i vlerësojmë lartë punën e palodhshme të mësimeve tona, të cilët kanë dhënë dhe po japin një kontribut të jashtëzakonshëm në arsimin e fëmijëve tanë”, tha nënkryetari Mazreku. “Ne si komunë, jemi të përkushtuar në ngritjen e objekteve të reja shkollore, me qëllim të rritjes së cilësisë në arsim dhe për këtë qëllim, kemi investuar dhe do të vazhdojmë të investojmë në shkollat tona. Si rezultat, ne sot kemi shkolla moderne”, tha Mazreku.



Ndërsa drejtori i arsimit, Avdi Morina, tha se sot është ditë e veçantë dhe shumë e rëndësishme për kombin dhe shkollën shqipe. “Libri dhe lapsi, janë dy armët më të fuqishme që ne kemi” tha Morina, duke folur për shkollën dhe historinë e hapjes së shkollës së parë shqipe. “Ne sot, i nderojmë dhe i respektojmë të gjithë ata që dhanë dhe po japin kontribut në shkollat tona, për arsimimin dhe edukimin e brezave të rinj”, tha drejtori Morina.

Në fund të këtij aktiviteti, Drejtorja për Arsim dhe Edukim, ka ndarë mirënjohje në gjashtë fusha për shkollat dhe arsimtarët e dalluar, gjatë një viti shkollor, të cilët janë dalluar për aktivitete dhe sukseset e arritura, si ka dhënë mirënjohje edhe për veteranët e arsimit.

Rritja e nivelit të ujit ka bllokuar dy rrugë

Malishevë, 7 mars



Rënia e pandërprerë e shiut, gjatë ditës së sotme, ka bërë që të rritet niveli i ujit në lumin Mirusha, por edhe në përroska. Sipas të dhënave nga drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim, uji ka depërtuar në shkollën fshatit Burim, ku është dashur të intervenojnë ekipet e zjarrfikësve dhe shpëtimit, ndërsa mësimi është ndërprerë në atë shkollë.

Momentalisht, uji ka bllokuar rrugën Malishevë-Duhël dhe rrugën Mirushë-Gurbardh. Tek liqeni në Mirushë, uji ka mbuluar urën dhe si pasojë është bërë e pakalueshme rruga për në fshatin Gurbardh.

Po ashtu, uji ka depërtuar edhe në disa shtëpi banimi në qytetin e Malishevës, kryesisht në bodrume.

Gjendja aktuale është nën kontroll, por luten qytetarët që të mos lëvizin pa nevojë, pasi sasia e ujit në lum dhe përroska, është ende e madhe. Sipas drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Sejdi Paçarizi, ekipet emergjente janë në gatishmëri të plotë deri në qetësimin e situatës.



Kryetari Begaj uron mësuesit me rastin e 7 Marsit

Malishevë, 7 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, i ka uruar të gjithë veteranët e arsimit dhe të gjithë mësimmshënësit.

“Të nderuar veteran të arsimit, JU profesor e profesoresha, mësimmshënës në të gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit, ju përcjellë Urimet më të sinqerta, juve që keni përcjellë shumë gjenerata, i keni shërbyer arsimit shqip. Një jetë ja keni kushtuar të shërbeni në lëmisë më të rëndësishme të zhvillimit të kombit. Shumë ju çmon dhe respekton Ragip Begaj, kryetar i Komunës së Malishevës”.

Qetësohet situata nga përmbytjet e djeshme në Malishevë

Malishevë, 8 mars

Situata e përgjithshme nga përmbytjet e djeshme, është qetësuar dhe po shkon drejt përmirësimit. Momentalisht, vetëm rruga Malishevë-Duhël, është me vështirësi e kalueshme, ndërsa të gjitha rrugët dhe urat tjera janë të kalueshme. Po ashtu edhe mësimi po zhvillohet normalisht në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë ditës së djeshme, ka pasur vështirësi të qarkullimit në disa rrugë, ndërsa uji ka depërtuar në disa shtëpi dhe biznese, kryesisht në bodrume, si dhe ka përmbytje të fushave përgjatë lumit Mirusha.

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Sejdi Paçarizi, tha se ekipet emergjente vazhdojnë të jenë të gatishmëri të plotë, edhe pse momentalisht ka rënë niveli i ujit. Sipas tij, gjatë natës së mbrëmshme, të gjitha ekipet emergjente, kanë qenë të gatishmëri të plotë, ndërsa ekipet e drejtorive komunale, pastaj zjarrfikësit, Policia e Kosovës, ekipet e njësisë së “Ekoregjionit” dhe KFOR-i, njësia e LMT-së në Malishevë, i kanë ndihmuar qytetarët të lëvizin në pjesët ku kanë qenë rrugët e bllokuara.

Përndryshe edhe drejtoria për shëndetësi, ka bërë thirrje për kujdes gjatë përdorimit të ujit dhe i rekomandon qytetarët që vlohët uji para përdorimit. Edhe sipas njësisë së Hidroregjionit në



Malishevë, uji është i klorizuar, por vërehen turbulenca të vogla, mirëpo vazhdohet me monitorimin e gjendjes së ujit për pije.

Nga java e ardhshme fillon fushata e repelimit të kafshëve

Malishevë . 10 mars

Në kuadër të masave parandaluese dhe luftimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), nga e dita e hëne, 14 mars 2016, pritet filloj fushata e repelimit të kafshëve shtëpiake në territorin e Komunës së Malishevës. Fillimin e kësaj fushate të repelimit të kafshëve, e ka konfirmuar Shtabi Komunal, për luftimin dhe parandalimin e EHKK.

Repelimi i kafshëve, bëhet me qëllim të mbrojtjes nga përcjellja e rriqrave nga fusha, që përmes kafshëve barten tek njeriu dhe ndërprerjes së ciklit të shumimit të rriqrave, prandaj luten qytetarët që të jenë bashkëpunues në implementimin e kësaj fushate.

Të gjithë qytetarët, do të njoftohen me kohë për orarin e repelimit të kafshëve, në të gjitha vendbanimet.

U mbajt aktivitet për nderë të Ditës Ndërkombëtare të Gruas

Malishevë, 10 mars



Organizuar nga Komuna e Malishevës, përkatësisht zyrtarja për Barazi Gjinore, znj.Vera Bytyçi dhe Grupi Jo Formal i Grave në Asamblenë Komunale, sot është mbajtur aktivitet për nderë të Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Me këtë rast është vlerësuar lartë roli i gruas. Kryetari i Komunës së Malishevë z.Ragip Begaj, i ka uruar gratë malishevase, si dhe i ka inkurajuar ato që të jenë edhe më aktive dhe të luajnë rol të rëndësishëm në

vendimmarrje.



“Komuna e Malishevës nga aspekti i barazisë gjinore qëndron mirë, duke u bazuar në kohërat e kaluara, duhet të punohet në barazinë gjinore, me gëzon fakti që këtu jam para deputeteve, mjekeve, policeve, punëtorëve të arsimit, shëndetësisë, administratës, ngase që kjo tregon angazhimin e juaj drejt barazisë, edhe pse kushtet tona sa i përket barazisë nuk ekzistojnë ende, këmbëngulësia juaj dhe mos dorëzimi, do të ju dërgojë drejtë asaj çka ju kërkoni e që është barazia. Ju bëj apel që të mos dorëzoheni dhe të kërkoni atë çka juve ju takon dhe e meritoni, ngase edhe në kohën e luftës ju ishit të barabarta dhe luftuat sikurse edhe ne meshkujt, dhe tani duhet të angazhoheni dhe të jeni sa më aktive drejt shkollimit dhe lëmit tjera“ tha Begaj.

Një fjalë rasti, në këtë aktivitet i cili i kushtohet ditës Ndërkombëtare të Gruas ka mbajtur edhe anëtarja e KK-së të Malishevës, njëherit edhe kryetare e Grupit Jo Formal të Gruas, znj.Behije Sertolli e cila tha se”Ndikimi i gruas në ndryshimet dhe zhvillimet shoqërore është shumë i rëndësishëm, dhe ndikues i drejtpërdrejtë në zhvillimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe përparimtare. Pavarësisht sfidave që gruaja sot ballafaqohet, ajo gradualisht ka filluar të ketë pozitive të rëndësishme në përmirësimin e rolit të saj në institucionin e jetës publike e politike, dhe gjithë kjo falë punës dhe vullnetit që të jetë e barabartë në çdo sferë të jetës”, tha Sertolli, duke përfunduar me një thënie të një njeriu të mençur “Fuqizimi i gruas nuk është vetëm gjeja e duhur për të bërë, por është gjeja më e mençur”.

Më pas, znj.Feride Hoxha si kryetare e komisionit për përzgjedhjen e femrave të suksesshme, i ka prezantuar emrat e të përzgjedhurave, e ato janë: znj,Hidajete Mazreku, femra që ka kontribuar në emancipimin dhe vetëdijësimin e femrës, ndërsa mirënjohja e familjes së dëshmorit , ju nda nënës së dëshmorit të kombit Avni Buqaj dhe gruaja më të suksesshme në biznes znj,Fatime Limaj.

Për rolin e gruas në shoqëri në përgjithësi dhe në komunën tonë në veçanti, dhe angazhimin e gruas në vendimmarrje, kanë folur edhe anëtarët e KK të Malishevës, znj.Fillore Bytyçi dhe znj.Jetmire Vrenezi.

Është bllokuar rruga Mirushë-Gurbardh

Malishevë, 10 mars

Si pasojë e reshjeve të pandërprera, është rritur niveli i ujit në lumin Mirusha dhe në liqenin Mirusha. Rruga Mirushë-Gurbardh, është bllokuar, pasi sasi e ujit në liqen ka dalë mbi rrugë. Po ashtu, uji ka filluar të depërtoj edhe në rrugën në hyrje të Malishevës, përkatësisht rruga Malishevë-Duhël.



Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, këshillin qytetarët, që të përdorin rrugë alternative dhe ti reduktojnë lëvizjet e panevojshme me vetura, shiu i vazhdueshëm ka bërë që të ketë prurje të mëdha të ujit dhe në vende të caktuara, mund të ketë bllokim të rrugëve dhe urave.

Njësitë emergjente të Komunës së Malishevës, janë në gatishmëri, së bashku me njësinë e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit dhe me Policinë e Kosovës.

Bizneset turke të interesuar për bashkëpunim me Malishevën

Malishevë, 11 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot përfaqësuesin e kompanisë “SacSan” nga Bursa e Turqisë dhe në të njëjtën kohë, përfaqësues i disa bizneseve tjera, z.Ibrahim Ljajic, me të cilin ka biseduar për mundësinë e bashkëpunimit mes bizneseve turke të Bursës dhe bizneset nga Malisheva.



Kryetari Begaj, e ka njoftuar përfaqësuesin e këtyre bizneseve nga

Bursa, me kushtet që ofron Komuna e Malishevës, për zhvillimin e bizneseve, si dhe me situatën e përgjithshme të biznesit në Malishevë. Kryetari Begaj, i shpreh i gatshëm për bashkëpunim të ndërsjellë me komunitetin e biznesit nga rrethi i Bursës.

Ndërsa, z.Ljajiq, tha se komuniteti i biznesit, është in interesuar që të bashkëpunoj me bizneset lokale, por edhe me institucionin e komunës, në fushën e infrastrukturës në shëndetësi, arsim dhe infrastrukturës tjetër.



Bie niveli i ujit në lumin Mirusha

Malishevë, 11 mars

Ndërprerja e shiut, ka bërë që të filloi të bie niveli i ujit në lumin Mirusha, si dhe në liqenin në Mirushë, mirëpo rruga Mirushë-Gurbardh vazhdon të mbetet e pakalueshme, si dhe rruga Malishevë-Duhël, me vështirësi e kalueshme, ndërsa masat preventive dhe kujdesi i shtuar, vazhdojnë të jenë në fuqi.

Sipas Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, niveli i ujit në liqenin Mirusha, ka rënë për afro 20 centimetra, mirëpo rruga që lidh fshatin Gurbardh, mbetet e mbuluar, e po ashtu edhe rruga në dalje të Malishevës, është vështirë e kalueshme, andaj qytetarëve ju rekomandohet të shfrytëzojnë rrugët alternative.

Sipas drejtorisë, ekipet e kësaj drejtorie, së bashku me të gjitha organet tjera të sigurisë, janë në gatishmëri të plotë, edhe pse niveli i ujit në lumenj e përroska është u ulur gradualisht.

Melos Ulluri, zgjidhet kryetar i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Malishevë

Malishevë, 11 mars

Sot, është mbajtur Kuvendi Zgjedhor i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL), i cili zgjodhi kryetarin, kryesinë dhe bordin. Kryetar i KVRL-së u zgjodh Melos Ulluri, ndërsa nënkryetar i parë u zgjodh Ardian Telaku, nënkryetare e dytë Dorina Toplana, sekretare Alma Krasniqi, ndërsa arkëtar Albert Thaçi.

Në këtë mandat dyvjeçar Bordi i zgjedhur nga kuvendi është në këtë përbërje:

1. Premton Mazreku
2. Ismail Mazreku
3. Leonora Javori
4. Arjon Krasniqi
5. Jetlira Buzhala

Kuvendi ka bërë ndryshime në nenin 4, pika 4.1, në statutin e KVRL-së.



Filloi cikli i parë i repelimit të kafshëve

Malishevë, 14 mars



Sot, në territorin e Komunës së Malishevës, ka filluar cikli i parë i fushatës për repelimin e kafshëve shtëpiake, si masë parandaluese ndaj etheve hemorragjike krime kongo (EHKK). Repelimi i kafshëve, bëhet me qëllim të mbrojtjes nga rriqrat si bartës të virusit të EHKK, të cilët përmes kafshëve barten tek njeriu si dhe për ndërprerjen e ciklit të shumimit të rriqrave, përkatësisht pamundëson, që rriqra të ushqehet nga kafshët.

Repelimi i kafshëve, bëhet nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit, në bashkëpunim të ngushtë me drejtorinë komunale për bujqësi dhe shtabin komunal, për luftimin dhe parandalimin e EHKK. Kjo formë e luftimit të EHKK, është në kuadër të zbatimit të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e EHKK.

“Repelimi i kafshëve, ka filluar sot në fshatrat Banjë dhe Gajrak, ndërsa ky është cikli i parë i repelimit. Deri në fund të vitit, pritet të bëhen katër cikle të repelimit”, tha drejtori për bujqësi, Hajrullah Mazreku, i cili e ka vëzhguar nga afër, fillimin e kësaj fushate. Sipas drejtorit Mazreku, në territorin e Komunës së Malishevës, janë rreth 18 krerë kafshë (të trasha dhe të imta), që do të rebelohen.

Repelimin e kafshëve, është duke e kryer operatori “Fauna”, i përzgjedhur nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit, ndërsa në ciklin e parë të repelimit, përdoret preparati “Butox”.



Java e kaluar, është përcjellë me përmbytje por dëmet nuk kanë qenë të mëdha

Malishevë, 14 mars

Këshilli i Drejtorëve, i drejtuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot takimin e rregullt të së hënës, ku drejtorët e drejtorive kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e drejtorive që ata drejtojnë, për javën që lamë pas dhe për planifikimi për javën në vijim.

Në mbledhjen e sotme, u raportua për situatën pas përmbytjeve të javës së kaluar. Sipas drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Sejdi Paçarizi, “dy herë brenda javës, ka pasur përmbytje, si pasojë e reshjeve të mëdha dhe daljes nga shtrati i lumit Mirusha, mirëpo, dëmet kanë qenë më të vogla në raport me vërshimet e janarit. Sipas tij, megjithatë, ka pasur dëme nga uji në infrastrukturë në përgjithësi, si dhe në ekonomitë familjare dhe biznese, por situata ka qenë nën kontroll.

Sa i përket fushës së investimeve dhe realizimit të projekteve, sipas drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, z.Ahmet Morina, momentalisht, është duke u punuar në disa projekte, dhe ajo që vlen të theksohet, është objekti i shkollës në Gurishtë, i cili është drejt përfundimit. Po ashtu, sipas Morinës, po vazhdojnë punimet në shkollat e Banjës dhe Astrazupit, pastaj ka përfunduar trotuari Bubavec-Kijevë, si dhe është duke u punuar në disa projekte tjera.

Edhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z.Milazim Morina, ka bërë të ditur, se janë duke u marrë me evidentimin e pikave ilegale të mbeturinave, në mënyrë që brenda mundësive, ti largojnë ato pika ilegale.

Edhe drejtoritë tjera, kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e drejtorive, ku sipas tyre, punët po shkojnë normalisht, nuk ka as pengesa dhe nuk ka as ankesa për kryerjen e shërbimeve komunale, në raport me qytetarët.



Komiteti për arsim mbajti mbledhjen e tretë të rregullt

Malishevë, 18 mars

Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, ka mbajtur sot mbledhjen e tretë të rregullt për këtë vit, ndërsa temë kryesore e kësaj mbledhje, ishte organizimi i aktiviteteve me rastin e shënimeve të festave të marsit, ku para anëtarëve të komitetit, kanë raportuar drejtori i arsimit Avdi Morina dhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi. Mbledhja është drejtuar nga kryesuesi i këtij komiteti, Januz Kastrati.

Sipas drejtoreshës Krasniqi, aktivitetet me rastin e shënimit të manifestimit “Epopeja e UCK-së”, janë zhvilluar sipas programit të paraparë në nivel qendrorë, ndërsa e veçantë në Malishevë, ka qenë organizimi me rastin e emërimit të shkollës së mesme profesionale, me emrin e dëshmorit “Kujtim Krasniqi”, ku është bërë edhe zbulimi i bustit, si dhe është mbajtur një akademi.

Ndërsa drejtori për arsim, Avdi Morina, gjithashtu i informoi anëtarët e komitetit lidhur me organizimin me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, ku është një takim me arsimtarët, di dhe janë ndarë edhe mirënjohje për mësuesit dhe shkollat më të suksesshme brenda një viti.

Drejtori i arsimit dhe anëtarët e komiteti, në këtë mbledhje, e kanë përgëzuar edhe nxënësin Urim Hoxha, nga ShMU “Ruzhdi Gjyliqi, i cili në olimpiadën e matematikës, në nivelin e klasave të nënta, e ka zënë vendin e parë në nivel vendi.

Më pas, anëtarët e komitetit, kanë planifikuar edhe vizita në disa institucione shkollore dhe të kulturës në Komunën e Malishevës, për tu njohur me gjendjen dhe aktivitete e këtyre institucioneve.

Begaj: Vizita në Gjermani, e frytshme

Malishevë, 21 mars

Në mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale, të mbajtur sot, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, vizitën e javës së kaluar në Gjermani, përkatësisht në qytetet Soest dhe Sundern, e ka cilësuar të suksesshme dhe e ka vlerësuar lart pritjen e udhëheqjes së këtyre qyteteve, si dhe të mërgimtarëve tanë që punojnë dhe jetojnë në këtë pjesë të Gjermanisë.



“Vizita që kemi bërë në Gjermani, ka qenë e frytshme. Kemi pasur shumë takime me kryetarët e këtyre dy qyteteve dhe departamentet tjera, e po ashtu na bërë është një pritje e jashtëzakonshme nga mërgimtarët tanë. Gjithashtu kemi vizituar edhe disa fabrika në këtë rajon dhe jemi takuar me komunitetin e biznesit”, tha kryetari Begaj, duke i informuar Këshillin e Drejtorëve, lidhur me vizitën në Gjermani.

Sipas kryetarit Begaj, kanë shkëmbyer përvoja në udhëheqje, në ekonomi, arsim dhe fusha tjera, si dhe kanë marrë ndihmë konkrete në fushën e arsimit, nga qyteti Soest. Gjatë vizitës në Gjermani, kryetari Begaj, ka qenë i shoqëruar nga drejtori për ekonomi, Vesel Krasniqi, drejtori për gjeodezi, Blerim Thaçi dhe zyrtari i lartë në drejtorinë e arsimit, Shefqet Kryeziu.

Përndryshe, në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, u raportua, se janë duke u realizuar disa projekte, si ai i shkollave në Astrazup dhe Banjë, si dhe fushat sportive në Llapqevë dhe Senik.

Po ashtu në këtë mbledhje, u tha se po vazhdon repelimi i kafshëve, ku deri më tani kanë përfunduar pesëmbëdhjetë fshatra, në ciklin e parë, ndërsa dezinfektimi i zonave endemike, varësisht nga kushtet atmosferike, pritet të filloj nga gjysma e muajit e prill.

Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e tretë të rregullt

Malishevë, 21 mars

Komiteti për Politikë dhe Financa, (KPF), organi i Kuvendit të Komunës, i cili drejtohet nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e tretë të rregullt për këtë vit, ku ka trajtuar një varg çështjesh dhe ka dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Në mbledhjen e sotme, KPF, e ka shqyrtuar planin e punës të zyrës së prokurimit për vitin 2016, ku anëtarët e komitetit, janë njoftuar nga udhëheqësi i zyrës së prokurimit në Komunën e Malishevës, z.Ekrem Kastrati, lidhur me planifikimet e kësaj zyre, i cili dhe është përgjegjës në pyetjet e parashtruara nga ana e anëtarëve të KPF-së.



KPF, pas shqyrtimit, e ka miratuar kërkesën e drejtorisë së Urbanizimit, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.02/134, për Planin Zhvillimor Komunal dhe këtë kërkesë, e ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, KPF, ka rekomanduar edhe planin komunal për efikasitet të energjisë 2016-2020. Po ashtu për mbledhjen e ardhshme të KK-së, janë rekomanduar edhe propozimin e dalë nga Asociacioni i Komunave, për shqyrtimin e pagesës për anëtarët e KK, si dhe rishqyrtimin e një vendimi komunal.

Komuna po vazhdon me ndërtimin e infrastrukturës shkollore

Malishevë, 23 mars



Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale, Komuna e Malishevës, momentalisht, është duke ndërtuar katër shkolla të reja dhe dy fusha sportive. Ecurinë e punimeve në dy nga këto projekte, e ka parë nga afërt edhe drejtori i urbanizimit, z.Ahmet Morina, me zyrtarë të tjerë (inxhinier) të kësaj drejtorie, ku ka kërkuar që këto projekte të realizohen sipas planifikimit dhe të ketë cilësi në punime.

Drejtori Morina dhe stafi i tij, i kanë inspektuar punimet në ndërtimin e objektit të shkollës në Astrazup, ku është duke u ndërtuar një shkollë moderne dhe që do të plotëson nevojat, sipas standardeve për mësimxënie, si dhe kanë vizituar punimet në ndërtimin e fushës sportive në shkollën e fshatit Llapqevë.

Sipas drejtorit Morina, “qëllimi i këtyre inspektimeve, është ecuria e realizimit të projekteve të filluara këtë vit dhe cilësia e ndërtimit”. “Ne po investojmë në objekte apo projekte të cilat duhet të kenë një jetëgjatësi dhe duhet të jenë të ndërtuara sipas standardeve, andaj edhe punimet duhet të kenë cilësi të lartë, siguri dhe të realizohen sipas planifikimeve tona”, tha Morina.

Shkolla në Astrazup ka një hapësirë prej 2909 metra katrorë dhe buxheti komunal, i kushton më shumë se gjysmë milion euro, ndërsa fusha e sportit në Llapqevë, ka dimensione standarde prej 44 metra gjatësi dhe 22 metra gjerësi dhe buxhetit komunal i kushton 31 208.82 euro.



Filloi realizimi i projektit të serrave për 15 bujq malishevas

Malishevë, 23 mars



Investimet në bujqësi, përkatësisht përkrahja për bujqit e Komunës së Malishevës, edhe këtë vit do të jetë prioritet. Për këtë qëllim, Komuna e Malishevës, përkatësisht drejtoria e bujqësisë, në mesin e disa projekteve që pritet ti realizoj gjatë këtij viti, nga sot ka filluar implementimin e projektit për ndërtimin e 15 serrave për bujqit malishevas.

Në fillimin e ndërtimit të serrave, kanë marrë pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku dhe drejtori i bujqësisë, z.Hajrullah Mazreku, të cilët i kanë uruar përfituesit e këtyre serrave dhe thanë se “angazhimet e komunës, në investime konkrete në bujqësi do të vazhdojnë”.

“Ne jemi duke u munduar ti ndihmojmë bujqit dhe bujqësinë në komunën tonë dhe këto serra janë në kuadër të këtyre përpjekjeve, prandaj uroj që ti gëzoni dhe të keni sa më shumë prodhim në mënyrë që tregu ynë të mbulohet me prodhime vendore”, tha nënkryetari Mazreku.

Ndërsa drejtori i drejtorisë për bujqësi, Hajrullah Mazreku, tha se drejtoria që ai drejton, është duke u munduar që përmes investimeve konkrete, ti përkrah bujqit malishevas në rritjen e prodhimeve në bujqësi, pasi është dega më e sigurt dhe më e fuqishme ekonomike ne kushtet tona. Drejtori Mazreku, tha se “investimet nuk do të mungojnë edhe në fusha tjera të bujqësisë, pasi bujqit dhe blegtorët tanë, janë duke investuar seriozisht ne rritjen e kapaciteteve”.

ATK rimbyllë dy lokale të lojërave të fatit

Malishevë, 23 mars

Departamenti Ligjor i Administratës Tatimore të Kosovës, nën asistimin e inspektoratit komunal në Malishevë, sot kanë mbyllur dy lokale të lojërave të fatit, pasi të njëjtat ishin mbyllur edhe më



herët, por janë rihapur ilegalisht dhe kanë ushtruar veprimtarinë e tyre, duke mos i plotësuar kushtet e parapara me legjislacionin në fuqi.

Sipas inspektorëve komunal, të njëjtat ishin mbyllur edhe më herët, pasi nuk e kanë respektuar largësinë në raport me institucionet publike, por ato janë hapur prapë, dhe kanë vazhduar veprimtarinë e tyre, duke mos i respektuar kriteret e parapara me ligjin mbi lojërat e fatit.

Kryetari Begaj, priti komandantin e LMT-së në Malishevë

Malishevë, 24 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij, komandantin e LMT-së, njësi ndërlidhëse e KFOR-it, Mauchle Benjamin. Ky takim kishte karakter përshëndetës, për shkak të ndërrimeve të rregullta në këtë njësi të KFOR-it zviceran, dhe me këtë rast kryetari Begaj, e falënderoi për bashkëpunimin e mirë dhe i uroi sukses në karrierën e tij të mëtutjeshme ushtarake.

“Kudo që shërbeni, brenda Kosovës, ju jeni në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Shpresoj që keni kaluar mirë në Malishevë dhe ju dëshiroj shumë suksese në karrierën tuaj ushtarake, nëse do ta vazhdoni këtë karrierë. Unë ju falënderoj për bashkëpunimin tuaj të mirë dhe për angazhimin tuaj, sidomos gjatë vërshimeve, ku në disa raste i keni ndihmuar qytetarët tanë dhe keni qenë përkrah neve”, tha Begaj.

Ndërsa komandanti i LMT-së zvicerane, M.Benjamin, sqaroi se ndërrimet në njësitë e LMT-së, “bëhen çdo gjashtë muaj, dhe se ka përvojë të jashtëzakonshme të bashkëpunimit të ndërsjellë me Komunën e Malishevë dhe me qytetarët e Malishevës”.



Edhe një sukses i nxënësve të Malishevës, në garat e matematikës

Malishevë, 24 mars

Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Avdi Morina, sot ka bërë të ditur, se gjatë kësaj jave, në garat matematikës, që i referohet garave të inteligjencës “EUREKA 3”, nxënësit Urim Hoxha dhe Pajtim Hoxha, kanë arritur rezultate të jashtëzakonshme, duke i fituar medaljen e artë, përkatësisht të bronzit. Ky sukses, vjen menjëherë pas triumfit në olimpiadën e matematikës, ku Urim Hoxha, kishte zënë vendin e parë.

Rezultatet, i ka konfirmuar vet drejtori Morina, i cili bashkë me nënkryetarin e komunës, z.Rexhep Mazreku, i kanë shoqëruar nxënësit e komunës sonë, të cilët kanë marrë pjesë në këtë garë në lëndën e matematikës, e cila i referohet garave të inteligjencës. Morina, ka treguar se këto gara janë zhvilluar në kolegjin “Hasan Nahi”.

Me këtë rast, drejtori Morina, i ka uruar nxënësit e shkollës “Ruzhdi Gjyliqi” nga Maralia, për këtë sukses të treguar. “Ky është niveli i arsimit në Malishevë dhe ne jemi të përkushtuar që ti përkrahim maksimalisht këta nxënës, dhe në të njëjtën kohë, të vazhdojmë të investojmë në arsimin e komunës sonë, me qëllim të rritjes së cilësisë në mësim”, tha drejtori Morina.

Sipas drejtorit Morina, nxënësit nga komuna jonë, pritet ta përfaqësojnë denjësisht Kosovën në garat ndërkombëtare dhe të sjellin të tjera rezultate të mira edhe në nivele më të larta.

Kryeministri Mustafa, shikoi nga afër dëmet nga vërshimet e janarit dhe marsit në Malishevë

Malishevë, 25 mars

Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z.Isa Mustafa, ka qëndruar sot në Malishevë, ku është pritur nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj. Vizita e kryeministrit, kishte për qëllim njohjen e drejtpërdrejt me dëmet e shkaktuara nga vërshimet e janarit dhe marsit në Komunën e Malishevës, ku dhe premtoi se do të ndahet një fond për intervenimet emergjente, me qëllim të evitimit të disa dëmeve.

Kryeministri Mustafa, ishte i shoqëruar edhe nga ministrat Avdullah Hoti, Ferid Agani, Adnan Abrashi dhe zëvendësministri i MAPL-së, z.Bajram Gecaj.



Kryeministri Mustafa, fillimisht është ndalur në Banjë të Malishevës, për tu njoftuar me dëmet e shkaktuar nga dalja e lumit në këtë pjesë turistike dhe më pas ka vizituar edhe digën në liqenin Mirusha, ndërsa është njoftuar nga kryetari Begaj, për dëmet e shkaktuara në këtë pjesë, si dhe për dëmet tjera të shkaktuara në qytet, si në ekonomi familjare, biznese, infrastrukturë dhe dëme tjera.

Pas kësaj, kryetari Begaj dhe qeveria komunale, kanë zhvilluar një takim të përbashkët në objektin e komunës, me kryeministrin Mustafa dhe kabinetin qeveritar, të cilët i kanë informuar në detaje me dëmet e shkaktuara nga vërshimet, si dhe për probleme tjera, me të cilat ballafaqohet Komuna e Malishevës. Pasi e falënderoi për vizitën, kryetari Begaj, tha se “dëmet nga vërshimet kanë qenë të mëdha dhe duhet intervenim emergjent, sidomos në digën e liqenit Mirusha, por edhe në shtratin e lumit, në mënyrë që të evitohen përmbytjet dhe vërshimet tjera, në të ardhmen. Problem tjetër i Malishevës, është edhe regjionalizimi me Gjakovën, ku qytetarët janë tejet të pakënaqur, pasi qytetari nuk është pyetur për këtë, ndërsa ne i kemi të gjitha lidhjet me regjionin e Prizrenit, qoftë lidhje historike, ekonomike, miqësore, natyrore, të komunikimit dhe çdo gjë tjetër na lidh me Prizrenin. Çështje tjetër problematike, është shfrytëzimi i pasurisë natyrore të Malishevës, nga gurëthyesit, ndërsa si komunë, asnjëherë nuk jemi kompensuar. Problem në vete është edhe Qendra e Kompetencës, ku agjencioni për arsimin profesional, ka marrë buxhet më shumë se që i takon kësaj qendre, si dha janë shkaktuar probleme tjera”. Dhe në fund, kryetari Begaj, kërkoi nga kryeministri Mustafa, që Qeveria e Kosovës, të ndihmoj në rregullimin e problemit të digës në liqenin Mirusha, shtratin e lumit dhe ndërtimin e rrugës transite në Malishevë, si probleme madhore aktuale.

“Kamë qenë tepër i preokupuar me vërshimet, në dy rastet, ku Malisheva ka pësuar më së shumti, por për fatin e mirë nuk ka pasur humbje në njerëz. Jam i interesuar për zgjidhjen e shpejt të këtyre problemeve emergjente, siç është diga dhe ura në liqenin Mirusha. Ne si qeveri do të bëjmë gjithçka për ndarjen e një shumë emergjente për dëmet e shkaktuara”, tha kryeministri Mustafa. Ai po ashtu tha se si qeveri “ janë duke i shikuar mundësitë për investimet strategjike, afatgjate, siç është rregullimi i shtratit të lumit, transitin dhe për digën e liqenit. Disa çështje mundemi këtë vit të rregullojmë dhe disa tjera më vonë”, tha kryeministri Mustafa.

Mustafa e Begaj, kanë biseduar edhe për çështje tjera, përfshi edhe ethet hemorragjike krime kongo (EHKK), ku kanë vlerësuar punën dhe angazhimin e të gjithë faktorëve, për luftimin dhe parandalimin e EHKK.



Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 29 mars

Komiteti për Komunitete, organ i obliguar i Kuvendit të Komunës, i drejtuar nga kryesuesi, z.Labinot Gashi, ka mbajtur mbledhjen e radhës, ku janë diskutuar raporti i punës për vitin e kaluar dhe plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2016, si dhe janë dhënë edhe disa rekomandime nga ana e anëtarëve të komitetit, për KKSB-në, e që kanë të bëjnë me sigurinë në përgjithësi.

Gjatë shqyrtimit të planit të punës së KKSB-së, për vitin 2016, anëtarët e Komitetit për Komunitete, thanë se “pavarësisht se është përfshi në këtë plan edhe siguria në shkolla, duhet të bëhet më shumë për rritjen e sigurisë, sidomos në komunikacion, në afërsi të shkollave, si dhe çështje tjera që lidhen me sigurinë e grupeve të caktuara, si nxënësit, pastaj siguria në komunikacion afër qendrave mjekësore dhe të tjera”.

Komiteti për Komunitete, ka diskutuar edhe për zbatimin e planit të punës, për muajin në vijim, ku janë paraparë një varg aktivitete, si vizita në vendbanimet ku jetojnë komunitetet pakicë, në shkollat ku shkojnë fëmijët e këtij komunitet dhe të tjera.

Përkujtohet masakra e Burimit

Pas 17 viteve, asnjë i dënuar për vrasjen e 42 shqiptarëve

Malishevë, 31 mars

Sot në Malishevë, është përkujtuar masakra e Burimit, ku u vranë dhe u masakruan 42 civil shqiptarë, kryesisht banorë të Dragobilit dhe Astrazupit. Për ta përkujtuar këtë masakër, më të madhen në Komunën e Malishevës, gjatë luftës së fundit, Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur një mbledhje përkujtimore, dhe më pas janë bërë homazhe tek varrezat e të vvarëve dhe në vendin e vrasjes, tek “vrella e Mëhillit “ në Burim. Në këtë përkujtim, u kërkua dënimi i autorëve dhe urdhërdhënësve, të cilët vranë dhe masakruan 42 shqiptar.



Në fjalimin e rastit, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, tha se “të gjithë këta, dhe shumë të tjerë të vranë, ranë për lirinë që ne sot e gëzojmë”. “Në këtë masakër, më të madhen brenda një dite, në territorin e Komunës së Malishevës, u vranë, pleq, të rinj, intelektual e bujq, u dogjën dhe u zhdukën shumë banorë të Dragobilit dhe Astrazupit”, tha kryetari Begaj, duke e kujtuar ngjarjen më të

dhimbshme, të 31 marsit të vitit 1999, masakër e cila u bë në shenjë hakmarrje ndaj luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe popullatës shqiptare dhe në kuadër të zbatimit të planit të shtetit serb, të gjenocidit mbi popullatën shqiptare.

Ndërsa kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, z.Aziz Thaçi, duke folur në këtë mbledhje përkujtimore, kujtoi se “për këtë masakër, ku u vranë, u masakruan, disa u dogjën, të tjerë që u zhdukën pa gjurmë, nuk u zhvillua asnjë gjykim dhe nuk u dënua askush, edhe pse dikush mbanë përgjegjësi”. “Kjo masakër, lëkundit vlerat e civilizimit dhe ata që bënë këtë masakër, duhet të dënohen nga gjykatat vendore apo ato ndërkombëtare”, tha kryesuesi Thaçi.

Në këtë mbledhje, kujtime ka evokuar edhe i mbijetuari i vetëm, z.Nuredin Morina, i cili kërkoi që kjo të mos harrohet dhe të dënohen ata që bënë këtë krim mbi popullatën e pafajshme. “Vetëm zoti e din se si kam shpëtuar, por kërkoi që kjo të mos harrohet” tha Morina, i cili i falënderoi të gjithë të pranishmit, në këtë mbledhje përkujtimore.

Më pas, familjarët, të afërmit, zyrtarët komunal të prirë nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike në Komunën e Malishevës, zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme, kanë bërë homazhe në varrezat, ku janë të varrosur viktimat e masakrës së Burimit dhe pas kësaj, është vizituar edhe vendi i ngjarjes, tek vrella e Mëhillit në Burim.